



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1.1 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe nenin 29.8 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia , Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 5 prill 2012, miratoi

Rregullore

Për Standardet e Raportimit dhe të Mbikëqyrjes së

Byrosë Kosovare të Sigurimit

Neni 1

Fushëveprimi

Byroja sipas të gjitha definicioneve do të mbikëqyrret sipas Rregullores së BQK-se për sigurime mbi *“Depozitimin e Aseteve si Garancë, Mjaftueshmerisë së Kapitalit, Raportimin Financiar, Menaxhimin e Riskut, Investimeve dhe Likuiditetin”*, ngjashëm me kompanitë e sigurimeve që veprojnë në Kosovë. Kjo Rregullore përmbledh rolin mbikëqyrës, përmbajtjen, afatet, kërkesat për raportim, kriteret e aprovimit të personave për pozita të rëndësishme dhe auditorit të jashtëm të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (me tutje: “Byroja”) nga ana e Bankës Qendrore (me tutje: “BQK”).

Neni 2

Qëllimi i Mbikëqyrjes

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që përmes mbikëqyrjes së Byrosë të synohet:

- a) Monitorimi dhe aprovimi i detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në sistemin e Kartonit Gjellbër;
- b) Monitorimi dhe aprovimi i detyrimeve ligjore që lidhen me trajtimin e dëmeve që janë objekt i Fondit të Kompensimit;
- c) Monitorimi i pagesave të dëmeve nga Fondi i kompensimit;

- d) Monitorimin dhe aprovimin e detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në Këshillin e Byrove;
- e) Monitorimin dhe aprovimin e detyrimeve të tjera ligjore që lidhet me veprimtarinë e Byrosë.

Neni 3

Metodat e Mbikëqyrjes

1. Mbikëqyrja e Byrosë do të realizohet nëpërmjet raportimit të rregullt të saj në BQK sipas përcaktimeve të kësaj Rregullore dhe nëpërmjet ekzaminimeve të rregullta nga zyra dhe në vend të fokusuara, nëse BQK e gjykon të nevojshme.
2. Mbikëqyrja nëpërmjet raportimit kryhet nga BQK-ja e cila shqyrton raportimet periodike të Byrosë, siç kërkohet me Rregulloren e BQK-se për Sigurimet mbi *“Depozitimin e Aseteve si Garancë, Mjaftueshmerisë së Kapitalit, Raportimin Financiar, Menaxhimin e Riskut, Investimeve dhe Likuiditetin”*
3. Raportimet e kërkuara të përcaktuara në këtë rregullore do të bëhen sipas Rregullores së BQK-se për Sigurimet mbi *“Depozitimin e Aseteve si Garancë, Mjaftueshmerisë së Kapitalit, Raportimin Financiar, Menaxhimin e Riskut, Investimeve dhe Likuiditetin”*
4. BQK-ja ndjek zbatimin e afateve të raportimit të Byrosë, siç është e definuar në Rregulloren e BQK-se për Sigurimet mbi *“Depozitimin e Aseteve si Garancë, Mjaftueshmerisë së Kapitalit, Raportimin Financiar, Menaxhimin e Riskut, Investimeve dhe Likuiditetin”*
5. BQK mund të parashtroj kërkesa tjera për raportim kurdoherë që e konsideron të nevojshme.

Neni 4

Komunikimi me BQK

1. Në kuadrin e ushtrimit të mbikëqyrjes, BQK-ja mund t'i kërkojë Byrosë çdo informacion ose dokumente që ndërlidhen me fushëveprimtarinë e Byrosë.
2. Byroja është e obliguar t'i dorëzoj BQK-së çdo informacion ose dokument të kërkuar, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 5

Përmbajtja e raportimit

Byroja është e obliguar që të raportoj në BQK për:

1. Financimin, investimin dhe administrimin e Fondit të Kompensimit;
2. Financimin, investimin dhe administrimin e Fondit Garantues të Kartonit të Gjellbër
3. Statutin e Byrosë dhe ndryshimet e tij të propozuara nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve;
4. Buxhetin vjetor të Byrosë dhe pjesën e financuar nga anëtarët e Byrosë, si dhe çdo burim tjetër të financimit;
5. Shitjen e policave të sigurimit kufitar sipas afateve të përcaktuara nga BQK-ja.
6. Dokumentacionin për miratim dhe raportin e auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare të Byrosë;
7. Njoftimin për pajisjen e anëtarëve të Byrosë me certifikata ndërkombëtare të sigurimit (kartonit të gjellbër).
8. Emetimin dhe administrimin e policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia referuar më poshtë si policë sigurimi dhe shenjës dalluese.
9. Furnizimin e kompanive të sigurimit me polica sigurimi dhe shenja dalluese.
10. Pasqyrat financiare tremujore dhe vjetore; që përfshin bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave dhe rrjedhën e parasë së bashku me informatat tjera të kërkuara nga BQK-ja.
11. Raportimin mujorë, tremujorë dhe vjetorë lidhur me obligimet dhe pagesat e dëmeve që rrjedhin nga marrëveshjet e mirëkuptimit (MoU) të lidhura me autoritetet e shteteve tjera.
12. Të dhëna statistikore dhe të dhëna të tjera për sigurimet të kërkuara rast pas rasti të auto përgjegjësisë dhe të tjera, sipas formave të përcaktuara nga BQK.

Neni 6

Miratimi i Financimit të Fondit të Kompensimit

1. Byroja është e obliguar që deri më 30 tetor të çdo viti, të dorëzoj për miratim në BQK:

a) planin e biznesit siç është përcaktuar në Nenet 34 dhe 35 të Rregullores së BQK-se për Sigurimet mbi *“Depozitimin e Aseteve si Garancë, Mjaftueshmerisë së Kapitalit, Raportimin Financiar, Menaxhimin e Riskut, Investimeve dhe Likuiditetin”*

b) shumën e kontributeve të projektuara për çdo kompani të sigurimit për financimin e Fondit të Kompensimit të vitit pasardhës;

c) çdo burim tjetër të financimit të Fondit të Kompensimit.

2. Kërkesave për miratim nga paragrafi 1 i këtij neni BQK-ja duhet t'u përgjigjet jo më vonë se deri me datë 30 nëntor të çdo viti.

3. Parashikimi i primeve neto të shkruara për llogaritjen e kontributit që duhet të paguajë çdo kompani e sigurimit anëtare e Byrosë, për financimin e Fondit të Kompensimit për vitin pasardhës, bëhet mbi bazën e:

a) primeve neto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia¹ të 12 mujorit të vitit paraardhës të pranuar zyrtarisht nga BQK;

b) mbi bazën e parashikimit 12 mujor të primeve neto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia, bërë nga çdo kompani siguri.

4. Llogaritja përfundimtare e kontributeve të Fondit të Kompensimit sipas pikës 3 të këtij neni, bëhet mbi bazën e përshtatjes së primeve neto të shkruara të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia të vitit paraardhës, në fund të muajit Janar të vitit ekzistues.

5. Kompanitë e sigurimit do të bëjnë kontribute shtesë në Fondin e Kompensimit në rastet kur fondet e parashikuara rezultojnë të jenë të pamjaftueshme për të kryer pagesat, Byroja duhet të njoftojë BQK-në paraprakisht për çfarëdo kërkesë shtesë nga kompanitë e sigurimit.

6. Financimet shtesë në Fondin e Kompensimit llogariten në të njëjtin raport që zë çdo anëtar i Byrosë në Fondin e kompensimit për vitin kur ndodh financimi shtesë. Përveç nëse është identifikuar si zë specifik i buxhetit të projektuar.

7. BQK-ja duhet të miraton çfarëdo financimi shtesë të Fondit të Kompensimit të parashikuar në paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni dhe tabelat e mënyrës së llogaritjes së tij, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e dorëzimit në BQK.

Neni 7

Raportimet për administrimin dhe investimin e Fondit të Kompensimit

1. Byroja është e obliguar që të raporton në BQK:

a) Çdo muaj, deri më 15 të muajit vijues, raportin analitik të dëmeve të paguara nga Fondi i Kompensimit si dhe pasqyrën përmbledhëse të dëmeve të raportuara, të paguara

dhe pezull (që gjenden në proces të kompensimit për pagesë), në numër dhe në vlerë të ndara në dëme materiale dhe jo materiale;

b) Çdo tremujor, deri më datën 30 të muajit vijues për financimin, administrimin dhe gjendjen në fund të tremujorit të Fondit të Kompensimit;

c) Çdo gjashtë muaj në lidhje me arkëtimet e realizuara nga ribmursimi.

2. Byroja raporton në BQK, deri më datën 15 të muajit vijues raportin mujor për gjendjen e aktiveve në mbulim të Fondit Garantues të Kartonit të Gjellbër dhe Fondit të Kompensimit, në ditën e fundit kalendarik të muajit përkatës.

Neni 8

Raportimi për Financimin dhe investimin e Fondit Garantues të Kartonit të Gjellbër

1. Byroja është e obliguar që të raportoj në BQK:

a) Çdo tremujor, deri më datën 15 të muajit vijues, shumën e kontributit në Fondit Garantues të Kartonit të Gjellbër të çdo anëtarit të autorizuar për të lëshuar Kartonin e Gjellbër, si dhe kopjet e Garancive Bankare që i korrespondojnë këtij Fondi sipas përcaktimit të paragrafit 2 të nenit 31 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga autopergjegjesia

b) Të gjitha rastet e përdorimit të mjeteve të Fondit Garantues të Kartonit të Gjellbër sipas parashikimeve të paragrafit 4 të nenit 31 të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopergjegjesia, brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përdorimit të këtyre mjeteve nga fondi duke i paraqitur edhe arsyetimet e përdorimit të tillë.

Neni 9

Raportimi i Buxhetit

1. Byroja duhet të propozon për miratim BQK-së Projekt Buxhetin për vitin vijues deri më 30 tetor të çdo viti.

2. Financimi i Buxhetit nga kompanitë e sigurimit duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga miratimi i tij nga BQK.

3. Në rast se Buxheti i parashikuar rezulton të jetë i pamjaftueshëm për të kryer veprimtarinë e Byrosë, kompanitë e sigurimeve financimin do të bëjnë financimin shtesë për buxhetin e Byrosë. Byroja do të njoftojë BQK-në paraprakisht sipas paragrafit 5 të Nenit 6.
4. Byroja raporton në BQK, financimin shtesë të Buxhetit brenda 10 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së tij në llogarinë përkatëse.

Neni 10

Përmbajtja dhe afatet e raportimeve të tjera në BQK

1. Byroja njofton BQK-në për datën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve dhe Këshillit Administrativ, jo më shumë se 10 ditë kalendarike para datës së mbajtjes të mbledhjes dhe dorëzon në BQK një kopje të vendimeve të marra në atë mbledhje brenda 5 ditëve kalendarike pas përfundimit të saj.
2. Byroja dorëzon në BQK:
 - a) Statutin si dhe çdo ndryshim dhe përmirësim të tij, 30 ditë para datës së miratimit të tij nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve.
 - b) BQK mund të kërkojë ndryshimin e Statutit nëse bie në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, dhe ia kthen për rishikim atë Byrosë.

Neni 11

Procedura e pajisjes së anëtarëve me Kartonin e Gjellbër

1. Byroja, dorëzon në BQK kërkesën e anëtarit për pajisjen me Karton të Gjellbër brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga paraqitja e saj.
2. BQK e shqyrton kërkesën për Programin e ri-sigurimit, të dorëzuar nga kompania e sigurimit, në përputhje me kriteret dhe afatet që i cakton BQK-ja.
3. BQK pas shqyrtimit të kërkesës për programin e ri sigurimit, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, njofton Byronë për aprovimin apo refuzimin e programit të ri sigurimit brenda tridhjetë (30) ditëve.
4. Byroja, njofton BQK-ne brenda pesë (5) ditëve kalendarike nga data e dhënies së autorizimit anëtarin për të lëshuar Karton Gjellbër.

Neni 12

Raportimi në BQK në lidhje me furnizimin me polica sigurimi

1. Byroja është e obliguar që të dorëzon në BQK për miratim , përpara emetimit, mostrat e policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia dhe shenjat dalluese të tyre.
2. Byroja fillon procedurën për emetimin dhe shtypjen e policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia pas marrjes së miratimit nga BQK-ja , në përputhje me rregulloret përkatëse të hartuara nga Byroja lidhur me emetimin, prodhimin, administrimin dhe shpërndarjen e tyre;
3. Emetimi i policave të sigurimit të detyrueshëm dhe shenjave dalluese, bëhet pas planifikimit duke marrë në konsideratë kërkesat e kompanive të sigurimit dhe të dhënat e marra nga BQK-ja.
4. Byroja raporton në BQK planifikimin e emetimit të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia për vitin pasardhës, për çdo kompani të sigurimit, brenda 15 ditëve nga data e përcaktimit të planifikimit përkatës;
5. Byroja, raporton në BQK çdo kërkesë shtesë për shtypje të policave të sigurimit nga autopërgjegjësia;
6. Byroja, raporton në BQK informacion të detajuar për sasi të furnizuar dhe sipas numrave serik të policave të sigurimit nga autopërgjegjësia për çdo shoqëri sigurimi;
7. Byroja, raporton në BQK në lidhje me nevojën e asgjësimit të policave të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia që duhet të dalin jashtë qarkullimit si dhe procedurën e vendosur për asgjësimin e tyre.

Neni 13

Auditori i jashtëm

1. Byroja është e obliguar që deri me datën 30 prill të çdo viti të dorëzoj në BQK raportin e auditorit të jashtëm të aprovuar dhe letrën e manaxhmentit lidhur me auditimin për vitin financiar të përfunduar . Raporti duhet të jetë në formë të shtypur dhe i nënshkruar si dhe në formë elektronike. Auditimi i jashtëm duhet të behet nga Kompani Auditimi të licencuara në Kosovë.
2. Byroja duhet ta njoftoj BQK-në për përzgjedhjen dhe ta dorëzoj kërkesën për miratim të Auditorit të Jashtëm jo më vonë se data 30 qershor të çdo viti.

3. Banka Qendrore është e obliguar që ta miratojë ose refuzojë auditorin e jashtëm brenda afatit prej 30 ditësh kalendarike nga data e pranimit të kërkesës.
4. Për te marre aprovimin e BQK-se për Auditorin e jashtëm të propozuar , Byroja duhet të paraqesë në BQK, dokumentacionin si në vijim:
 - a. Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Byrosë, për emërimin e Kompanisë së Auditimit të jashtëm;
 - b. Programin e Auditimit;
 - c. Vërtetimin se Auditori i jashtëm ka përvojë se paku 3 vjeçare ne auditimin e sektorit financiar
 - d. Të dhënat lidhur me përgatitjen profesionale dhe përvojën e auditorit te jashtëm (stafit te tij ne rast se auditori i jashtëm është i organizuar si kompani auditimi).
 - e) Të dhëna tjera shtesë që mund të kërkohen nga BQK-ja.
5. Byroja është e detyruar të marrë miratimin paraprak të BQK-së për çdo ndryshim të Auditorit të jashtëm.

Neni 14

Kërkesat për aprovimin e personave për pozitave të rëndësishme në Byro

1. Me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë dhe përshtatshmërisë (fit & proper) së personave të propozuar për pozita të rëndësishme, Byroja është e obliguar ti dorëzoj në BQK dokumentet si ne vijim:
 - a. Biografitë e të gjithë personave të propozuar;
 - b. Raportet e kompletuara të gjendjes financiare dhe burimeve financiare për personat e propozuar.
 - c. Raportimin në lidhje me personat e propozuar dhe punësimin e tyre të kaluar në çfarëdo kompanie të falimentuar dhe raportimi në lidhje me dosjet penale të këtyre personave.
 - d. Deklarata për konfliktin e interesave
 - e. Deklarata për konfidencialitet

2. BQK pas shqyrtimi të të gjithë dokumentacionit të kërkuar nga paragrafi 1 i këtij neni, do të nxjerrë vendim për aprovim apo refuzim të personave të propozuar për pozita të rëndësishme në Byro brenda 30 ditëve nga pranimi i kërkesës.
3. Për qëllime të këtij neni “pozita të rëndësishme ” konsiderohen pozitat si në vijim: anëtarët e këshillit administrativ me përjashtim të anëtarit pa të drejte vote të emëruar nga BQK-ja, Drejtori Ekzekutiv, drejtoret e departamenteve, përfshirë auditorin e brendshëm, koordinatoret, censorët, trajtuesit e dëmeve dhe juristet.
4. Përveç personave nga paragrafi paraprak të këtij neni BQK nëse e sheh të nevojshme, do të kërkojë aprovimin nga ana e sajë edhe të personave tjerë të propozuar për pozita tjera në Byro.

Neni 15

Dispozita Kalimtare

Neni 5 paragrafi 7 dhe neni 11 të kësaj Rregulloreje fillojnë së zbatuari në momentin e anëtarësimit të Kosovës në sistemin ndërkombëtar të kartonit të gjelbër.

Neni 16

Dispozita përfundimtare

Moszbatimi i dispozitave të kësaj Rregullore nga ana e Byrosë, do të ndëshkohet sipas dispozitave të nenit 38 të Ligjit për Sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më 17 prill 2012.

Gazmend Luboteni

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës